



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

---

Nr. 125 Prot

Tiranë, më 20.07, 2009

**VENDIM Nr. 9 dt. 20.07.2009**

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 20.07.2009,

**VENDOSI:**

**1. Për ndërhyrjet në objektet e trashëgimisë kulturore në qytetin e Korçës:**

- Të mos vendosen tezga në sheshin para ballit nga jashtë. Ky të gjelbërohet në një raport 70% x 30 %.
- Në rrugicat e Pazarit të kryhet restaurimi dhe plotësimi i kalldrëmit sipas teknikës ekzistuese.
- Të riparohen trotuaret me rrasë guri rreth dyqaneve me teknikën ekzistuese.
- Në rast se do të ndërhyhet në suvatimet e dyqaneve duhet të hartohen projekte mes Bashkisë Korçë dhe IMK.
- Të hiqet ndriçimi nga poshtë dhe të bëhet nga sipër sipas praktikës tradicionale (Bashkia Korçë + IMK).
- Kalldrëmi i sheshit Qëndro të Pazarit të kryhet me rrasë guri.
- Mbi dyqane të vendosen strehë mbrojtëse, me xham të tejdukshëm me profile të lehta metalike.
- Firma që do të kryejë punimet në Pazar të jetë në kontakte të vazhdueshme me DRKK Korçë dhe me IMK(e cila dhe do të mbikqyrë punimet).

**2. Për ndërhyrjet në objektet e trashëgimisë kulturore në qytetin e Shkodrës:**


- Në rrugën Branko Kadia shtresa e kalldrëmit të realizohet me gur gëlqeror pllakë me syprinën e lëmuar. Forma e pllakave katërkëndore kënddrejtë të jetë me përmasa 20-25cmx40cm. Me po këto lloj pllakash të trajtohen edhe kanalet edhe pusetat përkatëse.
- Kunetat e shkarkimit të ujërave të jenë në aks të shtresës si dhe kapakët e

- pusetave të jenë prej guri.
- Stolat të realizohen të kombinuara me dru dhe metal.
- Gjelbërimi të bëhet i ulët dhe dekorativ sipas karakteristikës vendore, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër.
- Të vendosen ndriçues dekorativ tradicional tip kollonë, në bashkëpunim me IMK, DRKK Shkodër dhe me Bashkinë Shkodër.
- Sinjalistika rrugore të realizohet me tabelat përkatëse me shigjeta.

### **3. Për ndërhyrjet në objektet e trashëgimisë kulturore në qytetin e Elbasanit:**

- Trotuaret e rrugës aksiale të Kalasë të realizohen me pllaka katërkëndëshe gëlqeror ose shtuf.
  - Shtresa e rrugës të realizohet sipas teknikës tradicionale me gur lumi të vendosur ratë dhe këlliç. Aksi i rrugës të realizohet me dy linja ngjitur tipike për kalldrëmet e rrugicave të Kalasë.( referohu në studimin “Recovering and improving Elbasan Fortess” by Roberto Pierini, Pisa University Press, fq. 203-205)
  - Në përputhje me rekomandimin për Kalanë e Elbasanit nga pikëpamja teknike ndriçimi të kryhet me tip kollone si në rastin e Shkodrës. (IMK+Bashkia Elbasan)
  - Në hyrjen lindore të Kalasë të kryhet sondazhi për zbulime të traktit origjinal të Via Egnatias në bashkëpunim me ASHA dhe IMK).
  - Mënyra e ekspozimit të këtij Trakti do të zgjidhet më tej në varësi të gjurmëve të zbuluara ose jo.
  - Shtresat mbajtëse të kenë trashësi të përshtatshme dhe në përputhje me trafikun lokal.
- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
  - Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
  - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**  
**ARDJAN/TURKU**



**SEKRETAR I KKR**  
**PROF. DR. VALTER SHTYLLA**

